



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.555/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mladen Stevanović, nga fshati Gorazhdec Komuna e Pejës, paraqitur kundër komisionerëve në Pejë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e Mladen Stevanović, nga fshati Gorazhdec Komuna e Pejës, me shenjën ZL.Anr.555/2017 e datës 30.10.2017, e parashtruar për shkak të parregullësive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 30.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Mladen Stevanović, nga fshati Gorazhdec Komuna e Pejës, të dërguar nëpërmjet postës më datë 24.10.2017, me të cilën ka pretenduar se në Shkollën Filllore “Janko Jovicevic” në Gorazhdec, në Vendvotimin 1715C/02D, ka shkuar për të votuar dhe se kur i kanë kontrolluar dorën e tij me llampë kanë konstatuar se ka votuar më herët. Më tej ka theksuar se gjatë tërë ditës ka punuar në arën e tij dhe se nuk ka votuar askund tjetër.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e Mladen Stevanović nga fshati Gorazhdec Komuna e Pejës, është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga parashtruesi i ankesës dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kërkesat e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: *“Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari”*.

Prandaj, PZAP-i nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr.555/2017 më datën 31.10.2017.



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*